



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Raport dhe procesverbal nga konsultimi publik për Kornizën Afatmesme (Buxhetore) të Shpenzimeve 2027-2029

Konsultimi është mbajtur më datë 15.06.2026 në Sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 10:00.

Linqet e publikimit të njoftimit për konsultim dhe të dokumentit:

Facebook-u i Komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid0kcKvoJkAveZDj2aoPUGeYhntm2Y6UBoL6PsHvQ75Zh486A4cgNR5JLgstzzDMHX7I>

Web-faqja e Komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid0kcKvoJkAveZDj2aoPUGeYhntm2Y6UBoL6PsHvQ75Zh486A4cgNR5JLgstzzDMHX7I>

Kuvendi Komunal në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa ka mbajtur konsultimin publik për Kornizën Afatmesme (Buxhetore) të Shpenzimeve 2027-2029.

Të pranishëm në konsultim ishin: Kryesuesja e Kuvendit, Arbnore Beqiraj-Fera, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Arditë Dërmaku, Zyrtari Certifikues / Aprovues në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Selami Zylfiu, Zyrtari për Buxhet dhe Financa, Labinot Dërmaku, Drejtorë të Drejtorive Komunale, zyrtarë komunal dhe të tjerë.

Konsultimin e hapi Kryesuesja e Kuvendit, Arbnore Beqiraj-Fera e cila tha se Korniza Afatmesme (Buxhetore) të Shpenzimeve 2027-2029 është dokument i rëndësishëm në të cilën janë paraqitur planifikimet për buxhetin e komunës.

Ndërsa në fjalën e saj Drejtoresha Arditë Dërmaku ka paraqitur në pika të shkurtra mënyrën deri tek miratimi i Kornizës Afatmesme (Buxhetore) të Shpenzimeve 2027-2029.

“Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029, si dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të

hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Më pas Kuvendi Komunal shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), e publikon në faqen zyrtare të komunës dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF deri me datë 30.06.2026. Për Komunën e Kamenicës me ardhjen e Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01, të datës 15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT, janë caktuar limitet e para buxhetore për periudhën 3 vjeçare 2027 - 2029 “, ka thënë ajo duke folur edhe për buxhetin e komunës.

“Krahasuar me vitin 2026, buxheti komunal është 15,605,103.00 Euro, për vitin 2027 buxheti i planifikuar është 15,329,208.00 Euro. Pra është më i vogël për 275,895.00(1.77%). Ky buxhet i planifikuar pastaj ndahet në: paga dhe mëditje 10,368,538,35 (67.64%), mallra dhe shërbime 2,225,875.00 (14.19%), shpenzime komunale 299,002,65 (1,.95%), subvencione 735,000.00 (4.79%), investime kapitale 1,700,792.00 (11.42%)”, është shprehur ajo.

Pas përfundimit të fjalës së saj fjalën e mori Selami Zylfiu hartuesi i KAB-it njëherit Zyrtar Certifikues / Aprovues në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Ai tha se ky dokument paraqet një nga dokumentet më të rëndësishmë dhe bazohet në Qarkoren Buxhetore 01/2027.

“Ky dokument është ndarë në disa pjesë si: bashkerenditja e aktiviteteve të qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027 – 2029, orientimet strategjike, korniza fiskale, parashikimi i rreziqeve të mundshme, perspektiva e politikave fiskale, Buxheti komunal për vitin 2027 – 2029, struktura e buxhetit për vitin 2027”, ka thënë ai duke shpjeguar edhe disa detaje tek kategoria e pagave.

“Tek Pagat dhe shtesa -Kategoria e shpenzimeve për paga dhe shtesa është përllogritur sipas kriterëve të kërkuara në qarkore 01/2017, ku si bazë për llogaritje është marr muaji prill 2026, edhe është përllogaritur vlera 0,5% për përvojën e punës për shërbyesit civil, ndërsa pozitat e pa plotesuara bazuar nga paga mesatare e Kosoves dhe nga shuma e kalkuluar 40% të buxhetit. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave në buxhetin e përgjithshëm është 67.64%”, ka theksuar ai.

Lidhur me Stafi, ai ka theksuar se nuk ka ndonjë shkurtim.

“Bazuar në Qarkoren buxhetore 2027/01 dhe në instruksionet e dhëna për komunën e Kamenicës, për vitin 2027 nuk kemi ndonjë shkurtim të stafit sipas tabelave dhe shënimeve qarkorja. Në qarkore shihet se ka një rritje të grantit të përgjithshëm në shumë 2,316,242.00 euro apo shprehur në përqindje 35.89%. Nga tabela e të dhënave statistikore dhe shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitet 2027 kemi një zvoglim të Grantit të Arsimit në shumë 2,250,610.00 euro. Nga tabela Granti specifik për Shëndetësi primare për vitet 2027-29 po ashtu shihet se ka një zvoglim në shumë 275,825.00 euro”, është shprehur ai.

Më pas është hapur debati për pyetje dhe diskutime nga të pranishmit.

Ismet Ahmeti: Cka do të thotë vlera 7.55% të të hyrat vetanake?

Zyrtari Selami Zylfiu: Shuma e tërësishme e të hyrave vetanake në raport me buxhetin komunal.

Ismet Ahmeti: Tek projeksionet po i shoh nuk po me duket projeksion i mirë. 1 milion e 68 mijë e 214 në suaza të të hyrave komunale, planifikimit të rritjes së tatimit në pronë, ku me ligjin e ri ndoshta në 2027 hyn rritja e tatimit në pronë ajo e rrit sigurish tatimin në pronë në minimum 300 - 400 mijë Euro. Pyetja ime: mosplanifikimi të hyrave konkretisht tek tatimi në pronë po u jep mundësi zyrtarëve që na e arrirem buxhetin qind për qind kur tendencat e rritjes së borgjeve janë duke u rritur.

Drejtoresha Arditë Dërmaku: Parashikimet mirren mesatare të të hyrave vetanake të tri viteve të fundit, për këtë e kemi një zvoglim për vitin 2026. Uroj të jetë ajo e mirë të arrijmë më shumë, por tash kështu e kanë planifikuar. Ndërsa Ligji për Tatimin përderisa ende nuk është i aprovuar ne nuk mund të parashikojmë në bazë të atij ligji.

Ismet Ahmeti: Poashtu pas rënies së madhe të subvencioneve duke ditur që viteve të fundit komuna ka realizuar praktika të mira të subvencioneve shembull kemi kategorinë e bujqëve ku ka shpërndarë plehra, makineri, subvencionim të qumshtit për litër etj. A nuk keni mundur të planifikoni më shumë?

Si dhe një pyetje: A mund të krijohet një fond rezervë në raste emergjente të komunës në mënyrë që të mos ndiqen procedurat e gjata që ne i dimë se cilat janë.

Zyrtari Selami Zylfiu: Parashikimet i jep MF dhe kufijtë buxhetor, e ne duhet t'i respektojmë. Uroj të mos jetë ky trend i burimeve të financimit sepse ka shkurtime të mëdha në burimet e financimit për 2027-2029. Andaj lidhur me subvencionet momentin që kemi një shkurtim të burimit atëherë automatikisht shkurtohen të gjitha subvencionet në sektorë të ndryshëm, përveç pagave që janë të mbrojtura me ligj. Ne me kryetarin e kemi bërë një kërkesë për sqarim se pse ka ndodhur kjo dhe jemi duke pritur.

Ndërsa lidhur me fondin rezervë nuk jam në dijeni që komunat tjera kanë fond rezervë por rezervat kalojnë në një linjë nëse ka keq-klasifilime sipas planit komptabël.

Zijadin Thaqi: A mund të ma shpjegoni shpërndarjen e buxhetit tek Zyra e Kryetarit që nga pagat, mëditjet, stafi i zyrës, udhëtimet zyrtare, aktivitete. Shuma e tërësishme për tri vitet e planifikuara.

Zyrtari Selami Zylfiu: Po kemi: Paga dhe mëditje 418,599.00 Euro, Mallra dhe shërbime 265,000.00 Euro, Subvencione 270,000.00 Euro, Numri i stafit 46.

Procesmbajtëse:





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes në konsultimin publik për Kornizën Afatmesme (Buxhetore) të Shpenzimeve 2027-2029.

Data: 15.06.2026

Ora: 10:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Gjinia	Vendbanimi	Nënshkrimi
Br.	Ime i prezime	Pol	Prebivalište	Potpis
1.	ZADIN HAJRI	M	KAMENICË	
2.	Ferinaze Selmani	F	Kamenicë	
3.	Violeta Krasniqi	F	Kamenicë	
4.	Shpend Morina	M	Kamenicë	
5.	Bebtesh Dërmolun	M	Kamenicë	
6.	URAN BERISHA	M	KAMENICË	
7.	ISMET AHMETI	M	KAMENICE	
8.	Nervadije Shala	F	KAMENICË	
9.	Leurina Guda	F	Karacavë e Poshtme	
10.	Sabirë Anu	F	Kamenicë	
11.	Lidiona Marovca	F	Kamenicë	
12.	NASER HOTI	M	KAMENICË	
13.	BESA MORINA	F	KAMENICË	
14.	Vjollca Azemi	F	Kamenicë	
15.	MERITA KRYEZIU	F	KAMENICË	
16.	Almira Spahiu Begiraj	F	KAMENICË	
17.	Besarta Ahmeti	F	KAMENICË	
18.	BURIM MAVRICAJ	M	KAMENICË	

19.	Vadele Benisha	F	Topanice	Bv.
20.	LABINOT DERRAKU	"	SHIPASHKIEE ER.	Derrak
21.	ARQITA DERRAKU	F	KAMENI G	ADerrak
22.	Arbnore Begiraj Fera	F	Karageve e fashtr	Begiraj
23.	Drinde Sejdin	F	ROGANE	Sejdin
24.	Sejmur Zymer	M	KOPERNICE	Suf
25.				
26.				
27.				
28.				
29.				
30.				
31.				
32.				
33.				
34.				
35.				
36.				
37.				
38.				
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				
44.				
45.				
46.				
47.				